



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujev

NJOFTIM PUBLIK

- *Komisioni për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës*
Nr.01-462/01-0076422/19
Datë: 24.09.2019

Bazuar në nenin 5 paragrafi 1 pikat 1.1; 1.2; 1.3 dhe 1.4, neni 6 paragrafi 1 pikat 1.1 dhe 1.2, nenin 8 paragrafi 1 pika 1.1, neni 14 paragrafi 1, 2, 3, 4, dhe 5 neni 15 paragrafi paragrafi 1, 2, 3, neni 16 paragrafi 1 dhe 2 dhe 19 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.1, 3.2 dhe paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim, dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, shpallim:

Njoftim publik për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë përmban:

- ***Pushimore për nxënës*** në Orllan e ndërtuar në parcelën kadastrale 1339-0- pjesë dhe 1341-2 me sipërfaqe 940m² zona kadastrale Orllan
- Fsh. Orllan Komuna Podujevë, objekti i Pushimores për nxënës në sipërfaqe prej 1650m² jepet në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite.
- Objekti mund të përdoret për veprimtari afariste, hoteliere dhe shëndetsore.
- Ndalohet i bartja e pronës së paluajtshme të komunës në personat e tretë
- Ndalohet dhënia e sajë me nën qira pa lejen e Komunës
- Para se të nënshkruhet kontrata për shfrytëzim afatgjatë fituesi eventual duhet të bëjë parapagimin për 6 (gjashtë) muajt e parë.
- Të drejtë konkurrimi kanë personat fizik dhe juridik
- Aplikacioni për konkurrim tërhiqet në zyrën për qytetarve nr. 14 ose në web fqene e Komunës nga data 25.09.2019 deri 10.10.2019, (ora 15)
- Ofertuesit e interesuar mund të shikojnë Objektin me datën 07.10. 2019 nga ora 14 deri në 15 takimi me të interesuarit për shkim të objektit me zyrtarin e Komunës do bëhet para objektit në fjalë.
- Çmimi fillestar dhe të gjitha kriteret tjera të përzgjedhjes për aplikim gjenden në aplikacionin e njoftimit publik i cili mund të tërhiqet në zyrën nr. 14, ose në web faqen e Komunës.
- Me datën 10.10.2019 nga ora 15:00 në sallën e komunës nr. 31, do të filloi hapja e ofertave në prani të komisionit vlerësues dhe ofertuesve, ofertat duhet të jenë të mbyllura në zarfet A4, dhe regjistruarara në intranet (protokoluara) në zyrën për qytetar nr.14
- Komision është autoritet për vlerësimin final të ofertave ekonomikisht më të favorshme për komunën.



Kryesuesi i Komisionit Vlerësues
Hamdi Jaha

APLIKACIONI I SHPALLJES PUBLIKE

TITULLI I SHPALLJES:

**Njoftim Publik për dhënien e Pronës së paluajtshme të Komunës
në shfrytëzim afatgjatë për 40 vite- Objekti i Pushimores për
nxënës në fshatin Orllan**

Shtator 2019

Informatat e përgjithshme

A. AUTORITETI KONTRAKTUES

Emri zyrtar: Komuna e Podujevës		
Adresa Postare: rr."Zahir Pajaziti" nr 8		
Qyteti: Podujevë	Kodi postar: 11000	Vendi: Republika e Kosovës
Personi kontaktues: Drejtori i DMMU-së: Hamdi Jaha		Telefoni: 038/200 41 006

B. LËNDA E KONTRATËS

Dhënia e Pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë për 99 vite - Objekti i Pushimores për nxënës në fshatin Orllan - Komuna e Podujevës

1. KUSHTET PËR PJESËMARRJE

Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Një deklaratë nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri të Ligjit Nr. 04/L-042, neni 65 (Ligji i prokurimit publik në Republikën e Kosovës), Dëshmi-Deklarata nën betim e nënshkruar dhe e vulosur.
- Vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve
- Vërtetimin nga Gjykata kompetente se nuk jeni të dënuar, apo nën hetime, për veprë penale, t Vërtetimin nga Gjykata kompetente se nuk jeni të dënuar, apo nën hetime, për veprë penale të parapar me Kodin Penal të Kosovës
- Vërtetim nga Drejtoria pr Buxhet dhe Financa e për tatimin në pronë.

Përshtatshmëria profesionale:

- Certifikata e regjistrimit të biznesit (Dëshmi-kopje),
- Certifikata e numrit fiskal (Dëshmi-kopje),

Kapaciteti teknik dhe profesional:

1. Përgatitjen e planit të biznesit të detajuar për pesë vitet e ardhshme, (5 pikë)
2. Dëshmi e stafit profesional për veprimtarin konkrete të aplikuesit, me përvojë pune, min.1 vit), (5 pikë)
3. Dëshmi (kontratë të lidhur me furnizues të artikujve ushqimor (mishit; bylmetit; pemëve dhe perimeve, të prodhuara nga fshatin Orllan me fshatrat tjera për rreth), nëse aplikuesi zhvillon veprimtari ku konsumohen këta artikuj. (10 pikë)

1. LLOJI I PROCEDURËS

- Njoftim (Shpallje) publike

2. KRITERET E PËRZGJEDHJES

KRITERET E PËRZGJEDHJES		
N r	Përshkrimi i kriterëve	Pikë (max 100)
1	Vlera e ofertës financiare.	50
2	Punësimi i minimum 15 punëtorëve të përhershëm dhe 15 (pesë) punëtorëve sezonal	30
3	Kapaciteti teknik dhe profesional	20

FUSHAT QË I PLOTËSON APLIKUESI

Çmimi fillestare i qirasë mujore përcaktuar nga komuna është 1,650.00 €

1. Çmimi i qirasë vjetore i ofruar nga aplikuesi : _____ €
2. Numri i të punësuarve të përhershëm që ofertuesi do ti angazhoj _____
3. Numri i të punësuarve sezonal që ofertuesi do ti angazhoj _____

C. SEKSIONI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

- INFORMATA SHITESË

- Aplikuesi i cili do të përzgjidhet nga ana e Komunës për shfrytëzimin e objektit afarist, do të jetë në mbikëqyrje të përhershme nga organet kompetente komunale të Podujevës,
- Shfrytëzuesi i objektit afarist duhet ta ketë parasysh që destinimi për çka është paraparë të zhvillohet në këtë objekt nuk mundë të ndryshohet,
- Shfrytëzuesi i objektit afarist do ti raportoj komunës në çdo 6 muaj,
- Investimet shtesë nuk mundë ti bëjë pa miratimin e komunës,

- Komuna e mbanë të drejtën që në rast të mos funksionimit të Objektit në fjalë sipas kontratës, mundë të e ndërpres njëanshëm kontratën para skadimit të afatit të sajë.
- Para nënshkrimit të kontratës shfrytëzuesi duhet të bëjë parapagimin për 6 (gjashtë) muajt e parë.
- **Këshilla juridike :** Çdo palë e pakënaqur me procesin e vlerësimit finale të ofertave nga komisioni, ka të drejtë të paraqesë **ankesë** brenda (15) ditëve, drejtuar Komisionin për Ankesa në Komunë. Ankesa dorëzohet në zyrën pritëse nr. (14)

D. TË DHËNAT E APLIKUESIT PËR MENAXHIM OBJEKTIT AFARIST

Emri zyrtar:		
Adresa Postare:		
Qyteti:	Kodi postar:	Vendi: Republika e Kosovës
Personi kontaktues:		Telefoni: Email-i :

Dorëzimi i Ofertave: Ofertat paraqiten para Komisionit Vlersues në zarf e mbyllur A4 me datën 10.10.2019 nga ora 15:00 dhe paraprakisht të protokolohen në Komunë në zyrën pritëse për qytetar nr. 14

Vlerësimi i Ofertave: Vlerësimi bëhet nga Komisioni Vlerësues i Kuvendit Komunal të Podujevës. Ofertuesit do të informohen me kohë dhe në bazë të afateve ligjore rreth vlerësimit të ofertave nga komisioni në fjalë.